



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 74, 75, 76, 77, 78 dhe nenin 79 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullën Nr. 19/2016, për Këshillat e Vendvotimeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 20.02.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevë 2020.

- I. Miratohet përbërja e Këshillave të Vendvotimeve (KVV), për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, që do të mbahen më 15 Mars 2020.
- II. Lista me përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve (KVV), si në pikën I të këtij vendimi, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 20.02.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Data/Datum 19.02.2020

Për/Za Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Permes/Preko Yll Buleshkaj, u.d Kryshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së

Nga/Od Nexhmedin Hyseni, Drejtor i Departamentit të Koordinimit në Terren

Kopje/Kopija Këshillin për Operacione Zgjedhore

Lënda/Predmet **Rekomandim për Formulen e Këshillave të Vendotimeve për Zgjedhjet Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë 2020**



Të nderuar Anëtar,

Bazuar në aktivitetin 190 të paraparë me Planin Operacional të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe paragrafit 5 të nenit 4 të Rregullës Zgjedhore 19/2016 për Këshillat e Vendotimeve, Sekretariati i KQZ-së me datë 25 shkurt 2020 do të bëjë Ftesën për Subjektet Politike lidhur me nominimet për Anëtar të Këshillave të Vendotimeve.

Mirëpo, meqë tashmë kemi një situatë ku për zgjedhjet në fjalë kanë aplikuar për certifikim vetëm tre (3) Subjekte Politike. Andaj, Sekretariati i KQZ-së, respektivisht Departamenti i Koordinimit në Terren dhe KKZ në Podujevë me qëllim të njoftimit me kohë dhe për të hequr dilemat rreth përbërjes së KVV-ve për zgjedhjet në fjalë, duke analizuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë e situatës së krijuar me dispozitat e parapara ligjore rekomandojmë si në vijim:

1. Përbërja e Këshillave të Vendotimeve të bëhet sipas nenit 76.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 4 paragrafi 1, 1.1, 1.2, më saktësisht paragrafit 3 të Rregullës Zgjedhore 19/2016 për Këshillat e Vendotimeve, që në fakt i bie se, secili Subjekt Politik i Certifikuar për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë të 15 marsit 2020 të kenë nga dy (2) Anëtar të KVV-së në një vendvotim.

Me respekt!